



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë-Ministarstvo Pravde-Ministry of Justice

Shërbimi Korrektues i Kosovës/Korrektivna Sluzba Kosova/Kosovo Correctional Service
Drejtoria e Përgjithshme

DOSJE PER OFERTIM

SHPREHJE E INTERESIT PËR OFERTIM

Data kur është përgatitur Dosja e Tenderit: 29.4.2025

Nr ¹ i procedures	33600	25	001
------------------------------	-------	----	-----

FURNIZIM DHE SHËRBIM
PËR
PRODUKTE USHQIMORE DHE PRODUKTE TJERA
PËR TE BURGOSURIT NË TË GJITHA INSTITUCIONET KORREKTUESE

Kjo dosje e ofertimit është përgatitur në gjuhët Shqipe, Serbe dhe Angleze

Ne rast se ka mospërputhje ne mes versioneve gjuhësore, versioni i gjuhës shqipe do te mbizotëron.

2025

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

TEMA: FTESE PËR OFERTIM për

Furnizim dhe shërbim për produkte ushqimore dhe produkte tjera për te burgosurit në të gjitha institucionet korrektuese

Ju faleminderit për interesimin e juaj për pjesëmarrje në aktivitetin e lartë përmendur të prokurimit.

Sipas kërkesës suaj, ju lutem gjeni të bashkangjitur dokumentet, të cilat përbëjnë Dosjen për Ofertim.

Nga ju pritët që të ekzaminoni me kujdes të gjitha pjesët, nenet dhe anekset e kësaj dosjeje për ofertim dhe të pajtoheni me të gjitha kërkesat, specifikimet dhe kushtet e përfshira këtu.

Ne, si Autoritet Kontraktues nuk pranojmë asnjë ndryshim.

Në rast të dështimit të dorëzimit për ofertim tek autoriteti kontraktues brenda afatit të caktuar në Dosjen për ofertim, dhe/apo nuk është pajtim me të gjitha kërkesat e paraqitura në dosjen për ofertim do të refuzohet dhe do të konsiderohet si “*oferta të papërgjegjshëm*”.

Të gjitha shpenzimet që lidhen me përgatitjen dhe me dorëzimin për ofertim duhet të barten nga tenderuesi, ndërsa autoriteti kontraktues nuk do të ketë asnjë detyrim në rast se anulohet procedura

Oferta duhet të dorëzohet në adresën e specifikuar në pjesën A “Procedurat e ofertimit para **datës 20.05.2025 në ora 14:00.**”

Me dorëzimin e ofertes, ofertuesi pranon në mënyrë të plotë dhe pa rezervime, kushtet e veçanta dhe të përgjithshme që rregullojnë këtë kontratë të propozuar si një bazë të vetme të kësaj procedure të ofertimit.

Mirëpresim pranimin e Oferten tuaj.

Nëse vendosni të mos e dorëzoni oferten, do të ishim mirënjohës nëse do të na lajmëronit me shkrim, duke cekur arsyet e vendimit të juaj.

Me nderitet,

Emri dhe Mbiemri: *Petrit Nishevci*

Nënshkrimi: _____

Qëllimi i Procedurës

Qëllimi i kësaj procedure është përzgjedhja e një operatori ekonomik për krijimin, operimin dhe mirëmbajtjen e një sistemi të integruar për menaxhimin e parave private të burgosurve dhe shitjen e artikujve ushqimorë dhe jo ushqimorë për të burgosurit.

Procedura për shprehjen e interesit do realizohet duke respektuar parimet e transparencës, konkurrencës së lirë dhe barazisë në proceset e konkurrimit mes operatorëve ekonomike.

Publikimi i kërkesës për pranim të ofertave nuk i nënshtrohet legjislacionit të prokurimit publik dhe nuk angazhon fonde publike.

Operatorët ekonomike të interesuar, duhet të ndjekin udhëzimet në këtë material për të ofertuar për dhënien e shërbimit të furnizimit të produkteve për nevoja të burgosur në Institucionet Korrektuese.

Operatorët ekonomik të interesuar mund të marrin informacion shtesë mbi mënyrën e funksionimit të kësaj procedure duke iu drejtuar autoritetit kontraktues.

UDHËZIME PËR OPERATORËT EKONOMIKË TË INTERESUAR

1. Hartimi i ofertës

1.1. Operatorët ekonomik janë të detyruar të përgatisin ofertën, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në këtë njoftim.

1.2. Operatorët ekonomik marrin përgjegjësi për kostot që lidhen me përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës së tyre. Autoriteti Kontraktues nuk ka obligime për kostot e krijuara.

1.3. Për këtë procedurë origjinali i ofertës duhet të shtypet ose të shkruhet me ngjyrë që nuk fshihet. Të gjitha fletët e ofertës duhet të lidhen së bashku dhe të jenë me renditje sipas numrit rendor. Të gjitha fletët e ofertës, përveç literaturës së pandryshueshme e të printuar duhet të pajisen me initiale ose të nënshkruhen nga personi(-at) e autorizuar. Çdo ndryshim në ofertë duhet të jetë i lexueshëm dhe i firmosur nga Personat e Autorizuar.

1.4. Operatori ekonomik, mban përgjegjësi për të gjithë dokumentacionin e paraqitur si pjesë e ofertës.

1.5. Paraqitja e kërkesave për shprehje interesi duhet të bëhet brenda afatit përfundimtar të përcaktuar në këtë shprehje interesi,

1.6. Kërkesat e paraqitura pas skadimit të afatit kohor nuk do të pranohen.

1.7. Informacioni që komunikohet gjatë hapjes publike të kërkesave që paraqiten në Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit Korrektues të Kosovës duhet t'i komunikohet të gjithë atyre Operatorëve Ekonomikë që kanë dorëzuar kërkesat e tyre.

1.8. Operatorët Ekonomikë duhet të dorëzojnë ofertën origjinale dhe dokumentacionin përkatës, të futur në një zarf jotransparent, të vulosur dhe firmosur me emrin dhe adresën e operatorit ekonomik dhe të shënuar: "Ofertë për procedurën me titullin e me poshtëm":

a) "Furnizim dhe shërbim për produkte ushqimore dhe produkte tjera për të burgosurit në të gjitha Institucionet Korrektuese"

b) Mos e hapni ofertën para datës 20.05.2025, ora 14.00.

1.9. Fshtësia e procesit është e garantuar. Autoriteti kontraktues nuk bën publik informacionet e marra nga operatorët ekonomikë, të etiketuara si konfidenciale. Ky lloj informacioni përfshin veçanërisht aspektet teknike, sekretet tregtare dhe informacionet konfidenciale të ofertave.

1.10. Të dhënat për çdo Institucion Korrektues – përfshirë informacionin për lokacionin dhe numrin e përafertë të burgosurve

2. Procedura e ofertimit:

Ofertimi i kësaj procedure është i ndarë në dy zarfa si:

Zarfi i parë i cili përfshinë dokumentacionin si në vijim:

1. Çertifikata e regjistrimit të biznesit;
2. Deklaratën nën betim.
3. OE duhet të përgatitë deklaratë ku merr përsipër se çmimet do të jenë sipas çmimeve të tregut ($\pm 5\%$) gjatë periudhës së kontratës.

Zarfi i dytë i cili përfshinë specifikat si në vijim:

1. Specifikat Teknike përfshinë:

1.1. Platformën për menaxhimin e parave private të burgosurve, porosive dhe pagesave e cila duhet të jetë në tri gjuhë (Shqip, Serbe dhe Angleze) përmban: 20 Pikë

- OE është i obliguar që në platformën elektronike të krijoj një modul të veçantë për qasje të secilit zyrtar përgjegjës nëpër institucionet korrektuese për gjenerim të llogarive për blerjet online për të burgosurit.

- Llogaria për të burgosurin duhet të përmbaj:

- Numrin unik të gjeneruar në platformën e blerjeve online.
- Fjalëkalimi për këtë llogari.
- Llogaria duhet të hapet sipas numrit unik të burgosurit i cili numër gjenerohet nga sistemi i të burgosurve në Shërbimin Korrektues të Kosovës,
- Të burgosurit nga këto llogari individuale mund të porositin, të shoh bilancin e tij dhe historikun e porosive,
- OE duhet të bëjë grupimin dhe klasifikimin e produkteve ushqimore dhe jo ushqimore sipas kërkesës së SHKK-së,
- Produktet ushqimore duhet të përmbajnë nëngrupet:
 - a) Ushqimore
 - b) Fruta dhe perime
 - c) Pijet jo alkoolike
 - d) Sublimente (Vitamina të ndryshme).
- Produktet jo ushqimore nëngrupet:
 - a) Veshmbathje
 - b) Cigare
 - c) Higjiena
 - d) Higjiena personale
 - e) Elektroshtëpiake

Menaxhimi elektronik i parave private të burgosurve dhe ndërlidhja me e-kantina: 10 pikë

- OE është i obliguar që të krijoj llogari të veçanta bankare në banka komerciale përmes të cilave do të përdor për menaxhimin e parave private të burgosurve.

- OE është e obliguar që të kujdeset që përmes kësaj llogarie të bëjë transaksionet nga transferet e jashtme që kryhen për të burgosurit.
- OE është e obliguar që të kujdeset për bilancin e mjeteve financiare të burgosurve në llogarit e tyre në e-kantina në të gjitha aspektet:
Transferet në e-kantina
Blerjet në e-kantina
Rimbursimi i mjeteve nga statusi final i bilancit financiar në e-kantina nga OE pas lirimit të burgosurve.
- SHKK do të transferoj pagat e të burgosurve për punën brenda IK në llogarinë kryesore të formuar nga OE për menaxhim të PPB dhe e-kantine.

Telefonia dhe shërbimet postare: 10 pikë

- OE është e obliguar që të lidh marrëveshje për shpenzimet e komunikimit telefonik të instaluar nga PTK në të gjitha IK për të burgosurit.
- OE është e obliguar që të lidh marrëveshje me OE tjerë të jashtëm për shpenzimet e shërbimeve pullave postare për të burgosurit.
- OE është e obliguar që të lidh marrëveshje me OE tjerë të jashtëm për shpenzimet e shërbimeve të zarfeve (plikove) për të burgosurit të rregullt.

- Kontrollat e sigurisë dhe transparencës: 10 pikë

- OE duhet të përgatisë platformën vetëm për blerjen e gjerave që porositen nga të burgosurit.
- OE është e obliguar që në rast të problemeve me platformën e tyre të bëjë zgjidhjen e problemit brenda 24 orëve.
- OE është e obliguar që të kujdeset për rezervat (backup) e të dhënave dhe blerjeve në kopje rezervë (backup) në rast të prishjeve eventuale të sistemit bazë apo ndonjë sulmi kibernetikë që shkakton prishjen e platformës. Ruajtja e backup-ve të platformës për SHKK duhet të jete në dy vende fizike të ndryshme.
- OE është e obliguar që ti përshtatet platforma e tyre me rregullat e sigurisë së TI në rrjetin shtetëror të RKS.
- OE duhet të ruaj proceset e ngjarjeve (logave) për blerjet apo transaksionet brenda platformës së përshtatur për SHKK.
- OE duhet të implementojë masa shtesë sigurie për të parandaluar keqpërdorimin e sistemit nga të burgosurit ose stafi, duke përfshirë monitorimin e transaksioneve dhe qasjen e kufizuar bazuar në rolet e përdoruesve.
- OE është e obliguar të bëjë testimin e depertimit (pentesting) të platformës dhe të raportoj.
- OE është e obliguar të sigurojë që platforma të mbështesë autentikimin biometrik opsional përmes njohjes së fytyrës (Face ID / Face Unlock) dhe skanimit të gishtërinjve. Këto metoda duhet të jenë të konfiguruar si opsionale dhe të mund të aktivizohen/deaktivohen sipas nevojës. Në çdo rast ku autentikimi biometrik nuk preferohet ose nuk është i mundur, sistemi duhet të sigurojë një mekanizëm të besueshëm të rezervës (fallback) përmes fjalëkalimit tradicional.

2. Deklaratë për Kapacitet Teknik dhe Burime Njerëzore, 10 pikë

- lista e stafit të OE;

- OE duhet të ketë të punësuar të paktën një (1) zyrtar të teknologjisë informative dhe një (1) programer të cilët duhet të dëshmojnë kualifikimet përkatëse apo marrëveshje me ndonjë kompani për mirëmbajtje të sistemit;
- Të disponojë e të ketë në pronësi të paktën 3 (tre) automjete tip furgon/minivan, për të cilat të dorëzojë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - a) Librezën e automjetit valide
 - b) Dëshmia e pronësisë apo marrëveshja për huazim

3. OE duhet të kenë kontratë/a të realizuar me sukses të natyrës së ngjashme për furnizim me produkte ushqimore dhe jo ushqimore: 20 pikë

-Dëshmi se ka të realizuara me sukses kontratë/a të natyrës së ngjashme (referencë).

4. Plani i zbatimit dhe koha e implementimit: 20 pikë

- OE duhet të ofroj plan të zbatimit të porosive dhe kohën e liferimit të mallit;
- OE është i obliguar që të punësojë të burgosurit (një i burgosur i punësuar për 70 të burgosur të cilët paguhen nga OE) dhe të trajtojë ata që të kryejnë porositë e të burgosurve dhe shpërndarjen e produkteve kur ato dorëzohen nëpër IK.
- OE është e obliguar që të mundësojë që çmimet e blerjeve online në platformë të jenë të harmonizuara sikurse në tregun jashtë IK.
- OE duhet që kur të përgatit porositë e të burgosurve ato të sjellën në IK me kodin e tyre unik të formuar gjatë regjistrimit në platformë nga administratori i IK-se.
- Produktet duhet të jenë të paketuara në qese të plastike të tejdukshme dhe të ndara sipas porosive që bëhen.
- OE duhet të sigurojë shporta të përshtatshme për shpërndarjen e porosive në IK.
- OE është i obliguar që të jete prezent gjatë dorëzimit të porosive të bëra nga të burgosurit në platformën online deri sa të kryhet skanimi i tyre nëpër skaner të ushqimeve për të parandaluar futjen e gjerave të dyshimta.
- OE do të mbajë përgjegjësi të plote ligjore për çdo përpjekje për futjen e artikujve të ndaluar brenda produkteve ushqimore apo jo ushqimore nëpër IK.
- OE është e obliguar që produktet që janë të ndjeshme të sjellën me automjete adekuate.
- OE është e obliguar që një herë në javë të bëjë furnizim me produktet e porositura sipas kërkesës së IK-ve.
- OE është e obliguar që të përgatisë raporte për blerjet online të të burgosurve, raportet të jenë javore dhe mujore të ndara për secilin të burgosur dhe IK. Po ashtu mundësi raport i avancuar i blerjeve.
- OE është e obliguar që sistemi i tyre të jete funksional dhe pa ndërprerje 7 dite në javë.
- Porosia e fundit që mund të bëhet është 48 orë para furnizimit.
- Afatet kohore për raportet: OE duhet të dorëzojë raportet në SHKK sipas kërkesës.

- Rregullat për kthimin e produkteve: Në rast se një produkt është i dëmtuar ose nuk përputhet me porosinë, OE është i obliguar të sigurojë procedura për rimbursim ose ndërrim brenda 48 orëve nga dorëzimi.
- Përcaktimi i përgjegjësisë për transportin: Nëse ka probleme me shpërndarjen e produkteve, përgjegjësia bie mbi OE për të siguruar dërgesat në kohë dhe në gjendje.
- Platforma të jete webaplikacion që të jete i qasshëm nga browser-et (shfletues) të internetit siç janë google chrome, edge, safari apo të ngjashme.
- OE është e obliguar të sigurojë funksionalitet në të dy forma të platformës si online ashtu edhe offline duke bërë të mundshme ruajtjen lokale të të dhënave kritike në rast të dështimit të lidhjes me internet dhe me rikthimin e lidhjes, të mundësohet sinkronizim automatik i tyre me pjesën tjetër të platformës tek OE duke përdorur mekanizma për ruajtjen e përputhshmërisë së të dhënave.
- OE duhet të sigurojë që platforma të jetë gjithmonë funksionale dhe aktive në kompjuterët që ai ofron, të cilët duhet të kenë specifikime të përshtatshme për Windows 11 dhe të jenë të pajisur me ekran touch screen, i cili funksionon plotësisht edhe nëse është i ndarë fizikisht nga njësi kompjuterike (shtëpiza). Kompjuterët mundën me qene të ndarë shtëpize dhe ekran por mundet me qene edhe All in One kuptohet të dy llojet patjetër touchscreen.
- Platforma duhet të jete në tri gjuhësi (Shqip, Serbisht dhe Anglisht).

Lista dhe sasia e kompjuterëve që duhet të jenë aktive për platformën e-Kantina dhe PPB:

Lokacionet e Institucioneve Korrektuese		
Institucioni	Komuna	Sasia e kompjuterëve
QK Dubravë	Istog	13
QK Smrekonicë	Vushtrri	1
QKM Lipjan	Lipjan	2
QKF Lipjan	Lipjan	3
Burgu i Sigurisë lartë	Podujevë	9
QP Prishtinë	Prishtinë	6
QP Gjilan	Novobërdë	7
QP Prizren	Prizren	1
QP Pejë	Pejë	1
QP Mitrovicë	Mitrovicë e Veriut	1
TOTALI		44

Kriteret për Vlerësimin e Ofertave

Pikat do të ndahen si vijon:

Kriteri	Peshë (%)
1. Zgjidhja teknike dhe funksionaliteti i sistemit (platformës elektronike)	50%
2. Eksperienca dhe përvoja e operatorit	20%
3. Kapaciteti logjistik dhe organizativ	10%
4. Plani i zbatimit dhe koha e implementimit	20%

Kategoritë		Përshkrimi i kriterëve	Pesha ³	Metoda e Vlerësimit
1	Platformës elektronike	Pikët <100x %> për ofertën me platformës elektronike më të mirë. Pikët e ofertes llogariten proporcionalisht.	50 %	$P = \frac{P_s}{P_t} \times [100x\%]^4$
2	Eksperienca dhe përvoja e operatorit	Pikët <100x %> për ofertën me shpenzimet më të mira operationale. Pikët e ofertes llogariten proporcionalisht (në shpenzime)]	20 %	$O = \frac{O_t}{O_s} \times [100x\%]^5$
3	Kapaciteti logjistik dhe organizativ	[Saktësoni] ⁶ [Merr në konsideratë një (ose më shumë) nga karakteristika(t) objektive matëse dhe jepi pikët<100x %> për tenderin me karakteristika(t) më të mira. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht (me nota).]	20 %	$C = \frac{C_t}{C_s} \times [100x\%]^7$
4	Plani i zbatimit dhe koha e implementimit	[Saktësoni] ⁸ [Merr në konsideratë një ose (më shumë) nga karakteristika(t) matëse dhe jepi pikët <100x %> për tenderin me asistencë teknike më të mirë. Pikët e tenderit llogariten proporcionalisht (me nota)]	10 %	$S = \frac{S_t}{S_s} \times [100x\%]^9$
			100 %	

NJOFTIMI I SHPALLJES TË INTERESIT DHE PRANIM TË OFERTAVE

1. Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor

Emri i AK: Shërbimi Korrektues i Kosovës
Adresa: Ndërtesa Ish Rilindja, Kati VI, zyra 619, Prishtine, Republika e Kosovës
Tel:
E-mail : zkip.shkk@rks-gov.net
Petrin.nishevci@rks-gov.net

Faqja e Internetit: <https://shkk.rks-gov.net>

Objekti i shërbimit ”Furnizimi me artikuj të ndryshëm për të burgosur në të gjitha IK-të”

Kohëzgjatja e kontratës: 5 (pesë) vite me mundësi vazhdimi edhe për 5(pesë) vite tjera.

Afati kohor për dorëzimin e shprehjes të interesit është jo më vonë se: 20.05.2025 ora 13.30

8. Afati kohor për hapjen e shprehjes të interesit: 20.05.2025 ora 14.00

9. Afati kohor për sqarime shtesë është deri më : 10.05.2025, ora 15:00

Nënshkrimi i kontratës

Njoftimi i fituesit

Autoriteti Kontraktor njofton Ofertuesin fitues, përmes dërgimit të njoftimit të fituesit në adresën elektronike dhe postare.

Operatori ekonomik fitues është i obliguar që të ofroj garancion nga ndonjë bankë apo kompani e licencuar në vlerë 500,000.00 (pesëqind mijë) Euro për periudhën 5(pesë) vjeqare .

Në rast të shkeljes së kontratës në çfardo forme Autoriteti Kontraktues do të bëj konfiskimin e garancionit.

Vendi i dorzimit te furnizimeve do te jete:

Lokacionet e Institucioneve Korrektuese		
	Komuna	Numri i përafërt i të burgosurve
QK Dubravë	Istog	760
Qk Smrekonicë	Vushtrri	100
QKM Lipjan	Lipjan	50
QKF Lipjan	Lipjan	45
Burgu i Sigurisë lartë	Podujevë	250
Qp Prishtinë	Prishtinë	300
QP Gjilan	Novobërdë	300
QP Prizren	Prizren	80
QP Pejë	Pejë	60
Qp Mitrovicë	Mitrovicë e Veriut	50

DEKLARATA NËN BETIM

Unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar: *[operatorin ekonomik që paraqitet]* deklaroj nën betim se i plotësoi të gjitha kushtet e parapra në këtë shprehje të Interesit.

Unë vërtetoj se i kam lexuar kërkesat e përshtatshmërisë në këtë shprehje Interesi dhe vërtetoj se i përmbush kërkesat e përshtatshmërisë për pjesëmarrje në këtë procedure të prokurimit.

Unë pranoj mundësinë e sanksionimeve penale dhe civile, gjobave dhe dënimeve, nëse unë për shkak të pakujdesisë dorëzoj çfarëdo dokumenti ose deklaratë që përmban informata përmbajtësish të gabueshme ose mashtruese.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i OE:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

SEKRET AFARIST

Për: [emri dhe adresa e autoritetit kontraktues]
(më tej "Autoriteti Kontraktues")

DUKE PASUR PARASYSH SE [emri i operatorit ekonomik] (më tej "Operatori Ekonomik"), duke përmbushur kërkesat e dosjes së ofertimit nën Nr. e Procedures të sipër-përmendur, si në vijim:

Identifikimi i informacioneve sekrete afariste dhe referimi në pjesët e dokumenteve të dërguara:

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE informatat e përmendura janë deklaruar që (i) nuk janë pronë publike, dhe (ii) janë të mbrojtura nga zbulimi i qëllimshëm ose nga pakujdesia nga ana e operatorit ekonomik ;

DHE DUKE PATUR PARASYSH SE qasja publike në informacionet e përmendura do të rezultonte me dëmtimin material të interesave legjitime komerciale të operatorit ekonomik për arsyet vijuese:

Deklaratë mbi natyrën e dëmit të tillë material dhe arsyet pse do të duhej të shfaqet:

PRANDAJ, unë, i poshtë nënshkruari, duke përfaqësuar Operatorin Ekonomik, nëpërmjet kësaj shpreh dëshirën që Autoriteti Kontraktues t'i klasifikojë dhe mirëmbajë informacionet e përmendura si informacione sekrete afariste.

Identifikimi i Operatorit Ekonomik (OE)	
Emri i Kompanisë:	
Adresa e plotë:	
I përfaqësuar nga:	
Emri:	
Pozita:	
Nënshkrimi:	
Data:	
Vula:	

KËRKESË PËR SHPREHJE INTERESI

(Emri i operatorit ekonomik)

[Data_____]

Për: *[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]*

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[objekti]*

Unë , i nënshkruari, paraqes kërkesën time për shprehje interesi për këtë procedurë:

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula